e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

MODULI I. Modernizimi i Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Himarë nepermjet Arkitekturës Web-Cloud.

Objekti kryesor është implementimi i një sistemi informatik të sigurt, i cili **duhet të** automatizojë ciklin e plotë të administrimit të taksave dhe tarifave vendore. Rezultati i dëshiruar është një platformë e matshme që rrit efikasitetin e mbledhjes së të ardhurave si me poshte:

Arkitektura e sistemit

Sistemi duhet të ofrohet si një shërbim i bazuar në Web dhe Cloud (SaaS ose ekuivalent funksional), duke mundësuar akses të centralizuar dhe menaxhim të unifikuar të funksionaliteteve dhe të dhënave.

Ndërfaqja e përdoruesit

Sistemi duhet të ofrojë një ndërfaqe Web moderne, të aksesueshme përmes shfletuesve standard të përdorimit të gjerë, me përshtatje automatike për pajisje desktop, tabletë dhe mobile, pa kërkuar instalim të softuerëve shtesë në pajisjet e përdoruesve.

Baza e të dhënave

Sistemi duhet të mbështetet në një sistem menaxhimi baze të dhënash të nivelit “enterprise” ose ekuivalent, të certifikuar për përdorim në mjedis Cloud, i aftë të përballojë volum të lartë të të dhënave dhe ngarkesa intensive pune, duke garantuar integritetin, sigurinë, mekanizma auditimi dhe disponueshmëri të lartë të të dhënave.

Siguria e aksesit

Aksesimi i sistemit duhet të realizohet përmes mekanizmave të sigurt të komunikimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit dhe politikat përkatëse të sigurisë.

Disponueshmëria e shërbimit

Operatori Ekonomik duhet të garantojë një nivel të lartë disponueshmërie të sistemit, i cili përcaktohet, matet dhe monitorohet përmes Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (SLA).

Sistemi duhet të ofrohet si shërbim software i hostuar në mjedis Cloud, i aksesueshëm përmes shfletuesit web, pa kërkesë për instalim apo konfigurim lokal në pajisjet fundore.

Transmetimi i të dhënave duhet të realizohet përmes protokolleve të sigurta HTTPS/TLS, duke garantuar konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave gjatë komunikimit.

Rezultatet konkrete që duhet të arrihen :

- **Aksesueshmëria:** Sistemi duhet të jetë plotësisht funksional përmes çdo shfletuesi Web, pa pasur nevojë për instalime lokale.
- **Disponueshmëria e Lartë:** Arritja e nivelit **99.9% Uptime**, i vërtetuar përmes raporteve mujore të SLA-së. “Disponueshmëria 99.9% llogaritet mbi bazë mujore, duke përjashtuar ndërprerjet e planifikuara të mirëmbajtjes të njoftuara paraprakisht.” shtojë
- **Integrimi i Shpejtë:** Lidhja në kohë reale me sisteme të tjera si e-Albania, QKB, platforma qendrore e Tatimeve dhe bankat përmes API-ve Cloud, duke mundësuar arkëtime të menjëhershme.
- **Sovraniteti i të Dhënave:** Sigurimi që të gjitha të dhënat fiskale të Bashkisë Himarë hostohen dhe ruhen në mjedis të sigurt dhe të audituara.

Operatori Ekonomik OE duhet të realizojë ecurinë e punës sipas fazave të mëposhtme:

1. **Analiza dhe Migrimi i të Dhënave:** OE duhet të kryejë analizën e bazës ekzistuese të të dhënave dhe të realizojë migrimin e tyre drejt mjedisit të databazës pa humbje informacioni.
2. **Zhvillimi i Moduleve Funktionale:** OE duhet të zhvillojë të gjitha modulet e kërkuara Referencat, Subjektet, Detyrimet, Likujdimet, Raportet dhe Importet.
3. **Integrimi me Platformat e Ndërveprimit:** Sistemi duhet të integrohet me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit përmes ESB-së, si dhe me sistemet e AKSHI-t, Sistemi qendror i Tatimeve, QKB dhe bankave të nivelit të dytë etj.
4. **Testimi dhe Trajnimi:** Kryerja e testimit të pranimit (UAT) dhe trajnimi i stafit të drejtorive përkatëse.
5. **Mirëmbajtja**

Mirëmbajtja do të fokusohet në:

- Përditësimin e sigurisë së serverëve Cloud.
- Monitorimin 24/7 të performancës së API-ve për ndërveprimin me institucionet e tjera

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit **duhet të** jetë për një periudhë 1-vjeçare (12 muaj).

Mirëmbajtja do të përfshijë:

- Monitorimin ditor të performancës së sistemit dhe logeve;
- Verifikimin e proceseve të backup-it dhe rikthimin testues të të dhënave;
- Azhurnimet e sigurisë, bazën e të dhënave dhe aplikacionin;
- Rivendosjen e shërbimeve në rast ndërprerjeje apo dështimi;
- Konsolidimin e indekse-ve dhe statistikave për optimizim të performancës.

Siguria e sistemit

Sistemi i ofruar nga OE **duhet të** garantojë nivelet e sigurisë sipas tabelës së mëposhtme, duke u bazuar në rregulloren e Bazave të të Dhënave Shtetërore

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input type="checkbox"/> D0	<input type="checkbox"/> I0	<input type="checkbox"/> K0	
<input type="checkbox"/> D1	<input type="checkbox"/> I1	<input type="checkbox"/> K1	<input type="checkbox"/> U
<input checked="" type="checkbox"/> D2	<input checked="" type="checkbox"/> I2	<input checked="" type="checkbox"/> K2	<input checked="" type="checkbox"/> M
<input type="checkbox"/> D3	<input type="checkbox"/> I3		<input type="checkbox"/> L

Niveli i sigurisë është i mesëm (M) pasi disponueshmëria dhe integriteti i të dhënave tatimore kërkojnë nivelin D2 dhe I2 për të garantuar shërbim të pandërprerë për qytetarët. Operatori Ekonomik duhet të zbatojë rregulloret e sigurisë të miratuara nga AKCESK në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

- Sistemi **duhet të** ndërveprojë me institucionet dhe platformat e mëposhtme:
 - **AKSHI :** Për shkëmbimin e të dhënave me regjistrat shtetërorë.
 - **Sistemi i Tatimeve dhe (QKR):** Për marrjen e të dhënave të bizneseve në nivel NIPT-i.
 - **Subjekte Financiare:** Për importin automatik të arkëtimeve ditore dhe rakordimin e faturave nepermjet komunikimeve API të pagesave nepermjet marrëveshjes 3 palese.
 - **e-Albania:** Për dërgimin e njoftimeve tatimore dhe dokumenteve të detyrimit të qytetarët dhe bizneset.

AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Periudha e zbatimit të kontratës **duhet të** jetë gjithsej 18 muaj nga data e nënshkrimit. Afati i implementimit të sistemit **duhet të** realizohet brenda 6 muajve të parë, ndjekur nga 12 muaj shërbim mirëmbajtjeje.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Operatori Ekonomik (OE) **duhet të** ofrojë një zgjidhje teknologjike të bazuar në arkitekturën **Web-based**, e cila operon në mjedis **Cloud** (Public, Private ose Government Cloud).

1.1. Arkitektura e kërkuar

- **Aksesueshmëria:** Sistemi **duhet të** jetë i aksesueshëm përmes shfletuesve standardë te përdorimit të gjere pa kërkuar instalimin e asnjë software-i shtesë në pajisjet e përdoruesve (Zero-Footprint), duke garantuar funksionim të vazhdueshëm në kushte normale operimi.
- **Hosting në Cloud:** Infrastruktura **duhet të** jetë e hostuar në një mjedis Cloud që garanton disponueshmëri të lartë.
- **Përditësimet Qendrore:** Çdo modifikim i tarifave apo përditësim i software-it **duhet të** aplikohet në sistemin qendror, duke u reflektuar menjëherë te të gjithë përdoruesit.

1.2. Specifikime Teknike për Teknologjinë Web-Cloud

Fusha Teknike	Specifikimi i Kërkuar
Ndërfaqja (Frontend)	E bazuar në teknologji moderne Web, shfletues standarte me dizajn të pershtatshëm (Responsive)
Siguria e Transmetimit	Çdo komunikim midis klientit dhe Cloud duhet të jetë i enkriptuar përmes standardeve ndërkombetare (HTTPS me SSL/TLS) ose ekuivalente
Autentikimi	Mbështetje për Multi-Factor Authentication (MFA) dhe integrim me sistemet e identifikimit shtetëror (SSO).
Skalueshmëria	Infrastruktura Cloud duhet të lejojë rritjen e kapaciteteve përpunuese automatikisht gjatë periudhave të ngarkuara.
API-First Design	Sistemi duhet të ofrojë API të dokumentuara mirë për ndërveprim të shpejtë me institucione të tjera.

Tabela e Specifikimeve Funktionale (KF)

Kodi	Emertimi i shërbimit	Pershkrimi Teknik i Funkcionalitetit
KF1	Ndërtimi I sistemit	Programi i taksave duhet të mundësojë regjistrimin e të dhenave referenciale baze për funksionimin dhe administrimin e sistemit, si mëposhte:

SF-1.1	Administrimi i Sistemit dhe Regjistrimi i referencave	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi i perdoruesve te sistemit. • Regjistrimi i roleve dhe te drejtave te perdoruesve • Percaktimi i listes se subjekteve per inspektor • Regjistrimi i struktures administrative(Organigrama)/Personeli • Regjistrimi i Adresave, Rruget dhe Zonat • Regjistrimi i arkave dhe bankat • Regjistrimi i tipeve te parametrave opsionale qe mund te kete nje biznes/prone/familjar, si psh: <ul style="list-style-type: none"> - Reklama - Zenia e hapësirës publike etj • Tipet e dokumentave qe duhen ne nje proces specifik, si psh: <ul style="list-style-type: none"> - Ekstrakti i QKR-se - Akt-Marreveshje - Certificate pronësie etj • Regjistrimi i normave te interesit per llogaritjen e kamat vonesave sipas publikimit te DPT-se. • Regjistrimi i llojeve te aktivitetit dhe lidhja me grupin e detyrimeve
SF- 1.2	Integrimi i legjislacionit	<ul style="list-style-type: none"> • Integrimi i VKB-ve dhe i legjislacionit perkates tatimor per drejtorine e te ardhurave, konsiston ne; • Up-date te te gjitha ndryshimeve ligjore ne fushen e legjislacionit fiskal ose te lidhura me te. • Up-date i te gjitha VKM-ve qe lidhen me fushen e administrimit tatimor ne nivel lokal • Azhornimi i paketes fiskale ose ndryshimeve te saj • Vendime te Keshillit Bashkiak qe lidhen me taksat apo tarifate ndryshme
		<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi i individit/personit fizik/personit juridik, te dhenat kryesore te subjektit si: <ul style="list-style-type: none"> - Emri, atesia, mbiemri (individe) * - Emertimi (person fizik/ person juridik) * - Forma juridike * - NID/NIPT * - Datelindja (individe) - Qyteti * - Rrugate * - Adresa - Zona - Telefon/Cel - Email - Adresa e njoftimit (adrese ku subjekti mund te njoftohet) - Te dhena shtese si (numri i dosjes, numer kontrate etj) • Regjistrimi i njesive te biznesit (adreses qendrore apo sekondare), te dhenat kryesore te njesise: <ul style="list-style-type: none"> - Numri serial-nipt (numer identifikues per njesite e biznesit) *

SF- 1.3	Regjistrimi i i bizneseve	<ul style="list-style-type: none"> - Forma Juridike * - Nipti * - Data e regjistrimit (drejtoria e te ardhurave) * - Data e licensimit (nga qkb) * - Rruga * - Adresa * - Drejtoria Operacionale(drejtoria e te ardhurave) * - Njesia Administrative * - Lloji i biznesit (opsional) * - Zona * - Lloji i aktivitetit * - Xhiro - Gjuha e tabelës (shqip, gjuhe te huaj, etj te jete referenciale) - Komentet (ne forme liste, ku te ruhen te gjitha veprimet dhe shenimet mbi kete njesi) - Aktet e konstatimit qe mbajne inspektorët ne terren • Administratori, te dhenat e administratorit/administratoreve <ul style="list-style-type: none"> - Emri - Atesia - Mbiemri - NID - Datelindja - Roli (administrator, ortak, pronar, bashkepronar) • Dokumentat, lista dokumentash ku te paracaktohet per cdo proces: <ul style="list-style-type: none"> - Emertimi - Numri i dokumentit - Data e protokollit • Njesi qendrore/sekondare (kjo te plotesohet automatikisht gjate regjistrimit) <p>Regjistrimi i parametrave opsionale te biznesit/prones/familjarit qe identifikohen nga inspektorët ose vete-deklarohen nga subjekti:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi i parametrave ne nivel te njesise se biznesit/prones/familjarit: <ul style="list-style-type: none"> - Lloji i parametrat (reklame, zenie e hapësirës publike) - Viti - Njesia matëse (siperfaqe, dhome, etj) - Vlera per njesine (numerike) - Kategoria (sipas paketes fiskale) - Komente te ndryshme - Dokument i regjistrimit/ndryshimit/anullimit
SF- 1.4	Regjistrimi i pronave	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi i pronarit: <ul style="list-style-type: none"> - Emri, atesia, mbiemri (individe) * - NID *

		<ul style="list-style-type: none"> - Datelindja * - Qyteti * - Rruga * - Adresa - Zona - Telefon/Cel - Email - Adresa e njoftimit (adrese ku subjekti mund te njoftohet) - Te dhena shtese si (numri i dosjes, numer kontrate etj) • Regjistrimi i pronave, te dhenat mbi pronen: <ul style="list-style-type: none"> - Numri i pasurise * - Zona kadastrale * - Data e regjistrimit (ne drejt.ardhurave) * - Data e fillimit (data kur do nisin detyrimet) * - Rruga * - Adresa * - Njesia Administrative * - Forma e pronesise * - Zona * - Lloji i pasurise * - Siperfaqja bruto * - Aktet e konstatimit qe mbahen gjate verifikimeve ne terren nga inspektoret. - Pronarin/pronaret, te dhenat kryesore: <ul style="list-style-type: none"> - Emri - Atesia - Mbiemri - NID - Datelindja - Roli (pronar, bashkepronar) - Pjeset e prones: <ul style="list-style-type: none"> - Data fillim - Data perfundim - Siperfaqja - Kategoria e prones (sipas paketes fiskale)
SF- 1.5	Regjistrimi i familjareve	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi i kryefamiljarit ; <ul style="list-style-type: none"> - Emri, atesia, mbiemri (individe) * - NID * - Datelindja (individe) - Qyteti * - Rruga * - Adresa - Zona - Telefon/Cel - Email - Adresa e njoftimit (adrese ku subjekti mund te njoftohet) - Te dhena shtese si (numri i dosjes, numer kontrate etj)

		<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi per kryefamiljarin: <ul style="list-style-type: none"> - Data e regjistrimit (ne drejt.ardhurave) * - Data e fillimit të detyrimeve * - Rruga * - Adresa * - Njesia Administrative * - Kategoria e kryefamiljarit * - Zona * - Siperfaqja *
SF 2	Funksionet e llogaritjeve dhe gjenerimit te detyrimeve	
SF- 2.1	Gjenerimi dhe llogaritja e detyrimeve	<p>Per cdo subjekt/pronar/prone qe regjistrohet me sukses, duhet qe sistemi te gjeneroje automatikisht detyrimet per periudhen aktuale tatimore duke u bazuar tek percaktimet ligjore,paketa fiskale miratuar nga Keshilli Bashkiak dhe fizionomia e biznesit. Sistemi duhet te llogarise automatikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Taksat <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi duhet te marre parasysh te gjitha komponentet e biznesit si: lloji i aktivitet, lloji i biznesit, njesia administrative, zona, xhiro etj - Kategoria e biznesit, per te percaktuar grupin e taksave. • Tarifat <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi duhet te marre parasysh te gjitha komponentet e biznesit si: lloji i aktivitet, lloji i biznesit, njesia administrative, zona, xhiro etj - Kategoria e biznesit, per te percaktuar grupin e tarifave. • Gjobat <ul style="list-style-type: none"> - Per te gjithë detyrimet apo grup detyrimet te konfirmuara nga specialisti, te cilat kane tejkeluar afatin duke u mbeshetur ne legjislacionin tatimor dhe duke perlllogaritur ditet Jo me shume se 365 dite • Kamatëvonesat <ul style="list-style-type: none"> - Lindin ne momentin e arketimit dhe do llogariten automatikisht bazuar në dite vonesat , shumen dhe interesat e publikuara nga DPT <p>Komponentet baze qe duhet te permbaje detyrimi jane:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ID (unik) • Njesia e biznesit • Viti • Afati

		<ul style="list-style-type: none"> • Kodi detyrim (kodunik shtatë shifror) • Numri i llogarise • Shuma e detyrimit • Shuma e likujduar • Data e likujdimit • Komente te ndryshme <p>Integrimi i tepricave debitore per vitet e kaluara.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formati i skedarit: <ul style="list-style-type: none"> - NIPTI - Njesia e biznesit/prona ku po ngarkohet detyrimi - Viti - Afati (opsional) - Kodi detyrim (kodunik) - Numri i llogarise - Shuma e detyrimit - Shuma e likujduar - Numri i kesit/kesteve
SF 3	Publikimi/Njoftimet	
SF- 3.1	Njoftimi i Detyrimeve	<p>Pas konfirmimit dhe aprovimit te detyrimeve, duhet te shfaqen dhe printohen :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njoftim detyrimi • Njoftim vleresimi • Njoftim rivleresimi tatimor • Njoftim per subjektet e reja • Vertetim likujdimi • Njoftim dhe kerkese per te paguar • Urdher bllokimi i llogarive bankare • Urdher ekzekutimi • Njoftim vendosje barre siguruese • Njoftim vendosje barre hipotekore
SF 4	Pagesat	
SF- 4.1	Arketime/Urdherpagesa	<p>Shkarkimi i pagesave duhet te kryhet ne 3 forma, duke perdorur arketimin, urdherxhirim nga banka dhe pagesat online</p> <p>Mandat i pageses duhet te permbaje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Subjekti (duke u kerkuar me kod, nipt/nid ose emertim)

		<ul style="list-style-type: none"> • Banka/Arka/Subjekt financiar (emertimi i bankes, i arkes ose i pales se trete) • Data e pageses • Numri rendor • Shuma totale • Teprice • Detyrimet e paguara, te dhenat: <ul style="list-style-type: none"> - Id e detyrimit - Emertimi i detyrimit - Viti, afati - Njesia e biznesit/prona - Shuma e paguar - Teprice - Debia e ngelur
SF 5	Raportimet	
SF- 5.1	Raportimi Analitik	<ul style="list-style-type: none"> • Raport i pergjithshem mbi subjektet/pronat • Raporti i pergjithshem per debitoret • Raporti i pergjithshem per kreditoret • Raport i pergjithshem mbi adresat/njesite e biznesit • Raport i subjekteve te pezulluara • Raport i pergjithshem per personat • Ditari i Arkes/Bankes • Ditari i pagesave te subjekteve • Raport i pergjithshem mbi parametrat • Detyrimet sipas njesive • Historiku i subjekteve • Historiku i veprimeve te perdoruesit • Statistika i detyrimeve • Statistika i subjekteve • Marreveshjet e borxhit
SF 6	Funksionalitet te tjera	
SF- 6.1	Funksionalitetet te tjera	<ul style="list-style-type: none"> • Baze te dhenash per pagesat qe replikon me bazen e sistemit te taksave [Pagesa Online] • Baze te dhenash per auditimit ku ruhen te gjitha veprimet/log-et te sistemit baze.

		<ul style="list-style-type: none"> • Nderfaqe per aprovimin e pagesave nga palet e treta (subjektet financiare) • API per dergimin e mesazheve [AKSHI] • API per dergimin e dokumentave [AKSHI] • API per njoftim detyrimi te subjektit/individit [AKSHI] • API per vertetim likujdimi [AKSHI] • API per marrjen e informacionit nga gjendja civile RGJC • API per marrjen e informacionit per subjektet nga DPT • API per printimin e njoftim detyrimi • Aplikacion per fushaten e printim/njoftim qe gjeneron ne seri skedare pdf per njoftimet • Aplikacion per fushaten e njoftimit nepermjet mesazheve ne e-albania [AKSHI]
--	--	--

12. Sistemi duhet te kete edhe nje asistent Virtual.

Ky propozim kerkon ekzistencen e një Agjenti të avancuar të Inteligjencës Artificiale (AI), i projektuar për të mbështetur Bashkinë e Himarës në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët – me zë dhe me shkrim, optimizimin e proceseve administrative dhe trajtimin e kërkesave si përmes telefonatave (me zë), ashtu edhe përmes sistemit të email/whatsapp.

Objektivat:

- T’u ofrojë qytetarëve përgjigje të shpejta dhe të sakta për pyetjet më të shpeshta.
- T’u ofrojë subjekteve apo individeve përgjigje për pyetje që lidhen me sistemin e taksave apo tarifave qe aplikohen. Aktet ligjore e nenligjore qe lidhen me to.
- Të informojë në mënyrë të detajuar qytetarët dhe subjektet mbi detyrimet tyre tatimore .
- Të reduktojë ngarkesën e punës për punonjësit e bashkisë, duke liruar kohë për aktivitete me vlerë më të lartë.

-Karakteristikat kryesore qe kerkohen per Agjentin AI

- Ndërveprim me zë: Qytetarët mund të telefonojnë bashkinë dhe të marrin përgjigje në kohë reale, natyrale dhe të ngjashme me komunikimin njerëzor nga Agjenti AI.
- Agjenti AI duhet te njihet me çdo përditësim të ligjeve, VKM-ve , VKB-ve, urdherave te ndryshem etj dhe ua komunikon ato me detaje qytetarëve kur adresojnë pyetje ne keto drejtime.
- Mbështetje me email: Kategorizim dhe përgjigje automatike të email-eve.
- Mbështetje shumëgjuhëshe: Përgjigjet mund të jepen në shqip, greqisht dhe anglisht , sipas preferencës së qytetarit.
- Panel analitik : Stafi i drejtorise se te ardhurave duhet të ketë akses në një panel me të dhëna dhe analiza mbi numrin e telefonatave, përgjigjet e përpunuara dhe matjen e kënaqësisë së qytetarëve.

PORTALI : E-TAKSA HIMARE

Portali mendohet të jetë një platformë elektronike e dedikuar për individet dhe subjektet juridike, krijuar për të ofruar transparencë dhe lehtësi në aksesimin e të gjitha **detyrimeve financiare lokale**, si taksat, tarifat apo debitë e prapambetura ndaj bashkisë Himarë.

Portali duhet të jetë i lidhur me sistemin e drejtorise se te ardhurave nga ku merren informacionet ne lidhje me faturat, debitë,kreditë etj

Aksesimi per individet

Për këtë, një përdorues, nëpërmjet kompjuterit, telefonit apo tabletit, duhet të krijojë një profil dhe me tej të mund të gjenerojë detyrimet e tija .

Aksesimi për subjektet (bizneset)

Subjektet juridike (si kompani, organizata etj.) duhet të hyjnë në portal duke përdorur **NIPT-in e tyre** dhe ne hapin e dyte mund të verifikojnë situatën financiare,detyrimet e prapambetura, ato te reja etj. Gjenerim dhe printim fature per bizneset/individitet.

Moduli II Menaxhimit Financiar

Moduli i **Menaxhimit Financiar** është komponenti qendror që transformon platformën nga një sistem mbledhjeje të ardhurash në një sistem të plotë menaxhimi financiar për Bashkinë. Ky modul integron automatikisht të ardhurat e gjeneruara nga modulet ekzistuese ("Faturat" dhe "Arka") me shpenzimet operative, duke ofruar kontabilitet me regjistrim të dyfishtë , menaxhim të buxhetit dhe raporte financiare në kohë reale.

Funksionalitetet e Modullit të Financës

(a) 1. Plani i Llogarive

Moduli do të mundësojë konfigurimin e plotë të planit kontabël të Bashkisë.

- **Struktura:** Përdoruesi do të mund të krijojë llogari të organizuara në nivele hierarkike (Klasa, Grupi, Llogaria sintetike, Llogaria analitike).
- **Qendrat e Kostos:** Mundësia për të lidhur llogaritë me qendra specifike kostoje (p.sh., Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Punëve Publike).

(a) 2. Regjistrimet në Ditar

Sistemi do të menaxhojë regjistrimet financiare në dy mënyra:

1. **Regjistrim Automatik:** Çdo veprim i kryer në modulin "Faturat" (krijimi i faturës) ose "Arka" (arkëtimi ditor) do të gjenerojë automatikisht fletë-hyrjen kontabël përkatëse në ditari.
2. **Regjistrim Manual:** Ekonomistët mund të shtojnë veprime manuale për rregullime ose transaksione jo të automatizuara.

(a) 3. Mbyllja e Periudhës

- Funksionalitet për mbylljen e muajit ose vitit fiskal, duke bllokuar modifikimet në periudhat e mbyllura dhe duke transferuar tepricat në vitin pasardhës.

Moduli i Shpenzimeve dhe Furnitorëve

Ky modul shërben për regjistrimin dhe menaxhimin e detyrimeve që Bashkia ka ndaj palëve të treta (furnitorëve, kontraktorëve, etj.), duke siguruar kontroll mbi paratë që dalin nga institucioni.

(a) **1. Regjistri i Furnitorëve**

Një bazë të dhënash për menaxhimin e kontraktorëve.

- **Shtimi i Furnitorit:** Përdoruesi klikon "Shto Furnitor" dhe plotëson fushat: Emri, NIPT, Adresa, IBAN, Tipi i shërbimit.
- **Historiku:** Çdo furnitor do të ketë një kartelë ku shfaqen të gjitha faturat dhe pagesat e kryera ndaj tij.

(a) **2. Regjistrimi i Faturave të Blerjes (Shpenzimeve)**

Hapat për regjistrimin e një shpenzimi:

1. Përdoruesi zgjedh furnitorin.
2. Plotëson të dhënat e faturës (Nr. Fature, Data, Vlera Totale).
3. Zgjedh zërin e buxhetit ose llogarinë e shpenzimit ku do të alokohet kjo kosto.
4. Ngarkon faturën fizike të skanuar në seksionin e dokumenteve.

(a) **3. Urdhër-Pagesat**

- Gjenerimi i urdhër-pagesave për thesarin ose bankën bazuar në faturat e miratuara të blerjes.
- Statuset e Urdhër-Pagesës: *Në pritje, E Miratuar, E Refuzuar, E Paguar.*

Moduli i Buxhetit

Moduli "Buxheti" është instrumenti kryesor për planifikimin financiar dhe kontrollin e shpenzimeve në raport me të ardhurat e parashikuara nga taksat.

(a) **Funksionalitetet e Modullit të Buxhetit**

(a) **1. Planifikimi Buxhetor**

- Përdoruesit mund të përcaktojnë limitet vjetore për çdo llogari shpenzimi dhe të ardhure.
- Mundësia për të shpërndarë buxhetin sipas muajve ose tremujorëve.

(a) **2. Monitorimi (Buxheti vs. Faktiku)**

- Sistemi ofron një tabelë krahasuese në kohë reale:
 - **Buxheti i Planifikuar**
 - **Realizimi Faktik** (bazuar në regjistrimet në GL)
 - **Diferenca (Mbetja)**
 - **Përqindja e Realizimit (%)**
- **Alarmi i Tejkallimit:** Nëse një përdorues tenton të regjistrojë një shpenzim që tejkalon fondin e mbetur, sistemi shfaq një njoftim paralajmërues.

Moduli i Aseteve

Moduli i Aseteve menaxhon inventarin e pasurive të qëndrueshme të Bashkisë dhe llogaritjen automatike të amortizimit të tyre.

(a) **1. Regjistri i Aseteve**

Lista e plotë e asetëve (ndërtesa, makineri, pajisje IT, automjete).

Kolonat e shfaqura në listë:

- **Kodi i Asetit:** Numri unik i inventarit (barkod).
- **Emërtimi:** Përshkrimi i asetit.
- **Data e Blerjes:** Data e hyrjes në Bashki.
- **Vlera Fillestare:** Kostoja e blerjes.
- **Norma e Amortizimit:** Përqindja e zhvlerësimit vjetor.
- **Vlera e Mbetur:** Vlera aktuale kontabël.

(a) 2. Llogaritja e Amortizimit

- Sistemi ekzekuton automatikisht amortizimin në fund të periudhës (muajore/vjetore).
- Gjeneron automatikisht regjistrimin kontabël (Shpenzim Amortizimi / Fond Amortizimi) pa ndërhyrjen e përdoruesit.

Raportet Financiare

Krahas modulit ekzistues të "Raporteve" që fokusohet te të ardhurat, ky seksion shton raportet e kontabilitetit të plotë.

(a) 1. Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

- (a) Raport që krahason të ardhurat totale (nga Taksat e Subjekteve dhe Familjarëve) me shpenzimet operative për të nxjerrë rezultatin financiar (Suficit/Deficit).

(a) 2. Bilanci i Gjendjes

- Paraqitja e Aseteve, Detyrimeve dhe Kapitalit të Bashkisë në një datë të caktuar.

(a) 3. Paneli Financiar

Një pamje vizuale e thjeshtuar në Panelin Qendror që përfshin:

- **Likuiditeti:** Totali i parave në llogari bankare dhe arkë.
- **Shpenzimet sipas Kategorive:** Grafik që tregon ku po shkojnë fondet (Rroga, Investime, Mirëmbajtje).
- **Top Furnitorët:** Lista e furnitorëve ndaj të cilëve ka detyrime më të larta.

Shtojca 7.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 8.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës që prokurohet.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të një pasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", I ndryshuar. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të ketë kapital të pakten 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin **2025** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vetë.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë **jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur** të objektit që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **10 (dhjetë)** punonjes për tre muaj e fundit, e vertetuar kjo me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj,
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar

Shënim: Kriteri 2.3.2 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

2.3.3 Për të garantuar implementimin, realizimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit si dhe suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

- a) Minimumi 3 (tre) punonjës ,secili me minimumi 7 (shtate) vite pervoje profesionale ne zhvillimin e zgjidhjeve informatike.

Për përmbushjen e këtij kriteri, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë të paktën një certifikim profesional për secilin punonjës, të lëshuar nga institucione të njohura ndërkombëtarisht, që vërtetojnë aftësi në zhvillim dhe programim software, si p.sh.:

- certifikime në zhvillim aplikacionesh, platforma software, ose gjuhë programimi,
- ose certifikime ekuivalente, të barasvlefshme për nga niveli dhe përmbajtja.

- b) Minimumi 1 (një) punonjës menaxher te projekteve IT. (*Minimumi 10 (dhjete) vite pervoje profesionale ne*)

Kjo kerkese permbushet permes certifikimeve profesionale te njohura nderkombetarisht ne fushen e menaxhimit te projekteve (p.sh PMP, PRINCE2, Scrum Master), ose certifikime ekuivalente.

- c) Minimumi 2 (dy) punonjës, me profil në administrimin dhe/ose implementimin e sistemeve të menaxhimit të bazave të të dhënave. (*Minimumi 8 (tetë) vite përvojë profesionale*)

Kjo vërtetohet përmes certifikimeve profesionale në fushën e databazave, të lëshuara nga organizata ose institucione përkatëse, ose certifikimeve ekuivalente.

- d) Minimumi 1 (një) punonjës me profil administrimin e sistemeve operative dhe infrastrukturës IT. (*Minimumi 8 (tetë) vite përvojë profesionale*)

Kjo vërtetohet përmes certifikimeve profesionale të njohura ndërkombëtarisht ose certifikimeve ekuivalente.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist në administrimin e databazave enterprise në mjedise cloud, (*Minimum 8 (tetë) vite përvojë profesionale në*

administrimin, konfigurimin, sigurimin dhe optimizimin e performancës së databazave të përdorura për sisteme kritike institucionale.)

Specialisti duhet të ketë certifikime profesionale të vlefshme në teknologji databazash enterprise (p.sh. Oracle, MS SQL Server, PostgreSQL Enterprise *ose ekuivalente*) dhe të demonstrojë përvojë në auditimin e sigurisë dhe menaxhimin operacional të databazave.

e) Minimumi 1 (një) punonjës me profil në përdorimin dhe/ose administrimin e platformave cloud. (*Minimumi 5 (pesë) vite përvojë profesionale*)

Certifikimi duhet të jetë i lëshuar nga ofrues të njohur ndërkombëtarisht të shërbimeve cloud (publike ose private), ose certifikim tjetër ekuivalent

f) Minimumi 1 (një) punonjës me profil në analizën e biznesit dhe/ose analizën funksionale të sistemeve software. (*Minimumi 6 (tetë) vite përvojë profesionale*)

Kjo kërkesë vërtetohet përmes certifikimeve profesionale përkatëse ose përmes përvojës së dokumentuar në projekte të ngjashme.

g) Minimumi 1 (një) punonjës me profil në testimin e sistemeve informatike. (*Minimumi 5 (pesë) vite përvojë profesionale, për realizimin e testeve funksionale dhe teknike*)

Kjo vërtetohet përmes certifikimeve profesionale në fushën e testimit software ose certifikimeve ekuivalente.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit

Te gjitha certifikimet e sipërpermendura duhet të jene aktive ne daten e ofertimit.

***Shënim 1:** *Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizma të akredituar, shqiptar ose te huaj.*

Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:

-Çertifikata për specialistët e kërkuar, të dhëna nga organizma të akredituar, shqiptar ose te huaj.

-Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (çertifikimin, diplomimin), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre.

-Listëpagesat sipas formularit e –Sig 25 për tre muajt e fundit sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër ose të paraqiten kontrata pune me punonjës që disponojnë certifikimet e kerkuara.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme, si mëposhtë:

